



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada - Government**

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
**Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of Minister of Justice**

Nr. 141 /2024  
Datë: 10 /06 /2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-118 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Znj. Adea Geci emërohet Udhëheqëse e Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Shfuqizohet vendimi nr. 209/2023, dt. 15.11.2023, me të cilin znj. Adea Geci është emëruar Zyrtare e Divizionit për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
3. E emëruara nga pika (1) e këtij vendimi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Mandati i të emëruarës në pikën (1) të këtij vendimi fillon me datë 10/06/2024 dhe zgjatë deri 10/06/2026, përkatësisht derisa të mos merret ndonjë vendim tjetër.
5. Paga e të emëruarës sipas pikës (1) të këtij vendimi do të paguhet si pagë primare në vlerën e koeficientit 7.40.

6. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Divizioni për Buxhet dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Meqenëse pozita e Udhëheqësit të Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ka mbetur vakante, dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe përgjegjësi që dalin nga legjislacioni përkatës në fuqi i kësaj fushe, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Albulena HAXHIU  
Ministre e Drejtësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Znj. Adea Geci;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Divizioni për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.